



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2018:066221

Datë: 11.11.2019

Numri i dokumentit: 00638837

**P.nr.523/2018**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Qemail Suka, me bashk. profesional Feim Bytyqi, në çështjen penale kundër të akuzuarit R. S. nga fshati Zh. Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 327 par.2 nënpar.2.1 të Kodit nr.04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.2892-1/2018, të datës 20.11.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në prani të Pokurorit të Shtetit Beqë Shala dhe të akuzuarit R. S., me datë 30.10.2019 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 04.11.2019 e përpiloi me shkrim këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari R. S.**, nga i ati A. dhe e ëma M. S. e vajzërisë B., i lindur me 31.01.2000, në fshatin Zh. Komuna e Prizrenit, ku edhe tani jeton, me numër personal ....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa martuar, i pa punë, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, më parë i padënuar për ndonjë vepër penale, mbrohet nga liria.

**ËSHTË FAJTOR**

Sepse me datë të papërcaktuar, gjatë muajit tetor 2018, në kohë të papërcaktuar, në fshatin L. Komuna Suharekë, saktësisht në shtëpinë e dajës së tij - të dëmtuarit F. B., i merrë pasurinë e luajtshme të tjetrit me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete, në atë mënyrë i pandehuri gjatë vizitave tek daja i tij - i dëmtuari F. B., në muajin tetor, shfrytëzon momentin pasi që viziton dajën e tij, hynë në dhomën e të dëmtuarit F. B., nga ormani merr para në shumën prej .11.800 euro, (njëmbëdhjetëmijë e tetëqind euro), të cilat i futë në duks — xhaketën e tij, largohet nga shtëpia e të dëmtuarit, më pas merr një banës me qëra në Prizren, në rrugën "R. K.", të gjitha paratë e vjedhura i shpenzon, me të cilat veprime të dëmtuarit i shkakton dëm të konsiderueshëm.

Me çka ka kryer veprën penale vjedhja e rëndë nga neni 327 par.2 nënpar.2.1 të KPK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të nenit 7, 41, 49 al. 1 pika 1.1, 50, 51, 52, 73, 74, 75, 76 të KPK-së dhe nenit 365 të KPP-së, të akuzuarit i shqipton:

**DËNIM ME KUSHT**

Ashtu që i vërteton **dënimin me burgim prej 2 (dy) viteve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afatin e verifikimit prej 3 (tri) viteve i akuzuari nuk kryen vepra tjera penale.

Obligohet i akuzuari që në emër të kompenzimit të viktimave të krimit të paguaj shumën prej 30 euro si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 euro, të gjitha këto pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari F. B. nga fshati L. Komuna e Suharekës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridik civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.2892-1/2018, të datës 20.11.2018 kundër të akuzuarit R. S. nga fshati Zh. Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale vjedhja e rëndë nga neni 327 par.2 nënpar.2.1 të Kodit nr.04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës.

Pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i shtetit Beqë Shala, i akuzuari ka theksuar se e ka kuptuar në tërësi akuzën dhe e ka pranuar fajësinë. Prokurori i Shtetit nuk ka patur kundërshtime lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Gjykata ne shqyrtimin e sotëm dhe me vet pranimin nga ana e te akuzuarit ka vërtetuar këtë gjendje faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga vet pranimi i te akuzuarit e cili ne shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë.

Gjykata sipas detyrës zyrtare konform nenit 257 te KPP-së ne shkresat e lendes nuk ka gjetur ndonjë prove te pa pranueshme dhe po ashtu gjykata ka vërtetuar se akuzuari, e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin te fajësisë, pranimi i fajit nga ana e te akuzuarit, është bere vullnetarisht ne shqyrtimin fillestar pranimi është mbështetur ne faktet e çështjes qe përmban aktakuza, te cilat gjinden ne shkresat e lendes si dhe provat materiale te paraqitura ndaj te akuzuarës nga ana e PTH-së ne Prizren.

Gjykata po ashtu ne tërësi ka ardhur ne përfundim se pranimi i fajësisë ne shqyrtimin fillstar nga ana e te akuzuarës, është bërë ne pajtim me dispozitat e nenit 248 te KPP-së, nga se nuk ekziston ndonjë nga arsyet dhe kushtet për hedhjen e aktakuzës, apo pushimin e procedurës penale.

Me rastin e marrjes të vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos gjetur rrethana rënduese, e që si rrethanë lehtësuese gjykata vlerësoi se i njëjti është i pa dënuar më parë, rrethanat personale dhe karakterin e të akuzuarit, moshën e re të të akuzuarit, bashkëpunimin e përgjithshëm të të akuzuarit me gjykatën, si dhe sjelljen korrekte të tij gjatë shqyrtimit, andaj gjykata i shqiptoi dënimin nën kufirin e paraparë me ligj, denim me kusht duke ia caktuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afatin e verifikimit prej 3 (tre) viteve nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi i akuzuari nuk kryen vepra tjera penale me bindje se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi kërkesën pronësoro juridike gjykata e bazoi në kuptim të nenit 463 të KPPK-së.

Vendimin mbi shpenzimet gjyqësore dhe paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 dhe 451 të KPP-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË P.nr.523/2018 të dt. 04.11.2019**

**Bashk.Profesional  
Feim Bytyqi**

**Gjyqtari  
Qemail Suka**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 dite nga dita e pranimin, ankesa dorëzohet nëpërmjet të kësaj gjykate.